

BASHKIA SHKODËR

RAPORTI I PERFORMANCËS

2019

DISCLAIMER

Raporti i performancës bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Shkodër gjatë vitit 2019 “**miratuar në Këshillin Bashkiak**”.

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Shkodër me asistencën e Projektit Bashki të Forta dhe Smart Processes.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

BASHKIA SHKODËR



Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike. Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për

zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit. Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal. Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballat me sukses me rrezikun e përmbytjeve”.


ORIENTIM AFATGJATË

Bashkia Shkodër mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qendërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Zona urbane e Shkodrës ka nevojë të krijojë qendërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qendërsi të reja urbane konsolidojnë strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale kanë nevojë për të përmirësuar qendrat ekzistuese. Kjo qasje do të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarkie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohe që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërhapur në territor. Ky skenar promovon një zhvillim shumë-dimensional të ekonomisë dhe arritjen e qëllimit për zhvillimin rajonal duke promovuar edhe kohezionin territorial. Gjithashtu, krijohet një hierarki qendrash nga primare urbane (qyteti Shkodër) deri tek qendra locale, të cilat ofrojnë shërbime bazë për komunitetin. Gjithashtu skenari policentrik promovon mbrojtjen e burimeve natyrore e ujore duke garantuar mundësinë për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor sipas parashikimeve të PPK dhe PINS.

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME 2019

PROFILI

Popullsia



11 njësi administrative

873 km²
sipërfaqe

BASHKIA SHKODËR


Kryetari i Bashkisë



Voltana Ademi

Këshilli i Bashkisë

51 anëtar



Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

- Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta tregojnë kapacitetin financiar të bashkisë dhe përfshijnë përveç taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga asetet dhe donacionet edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë.
- Të ardhurat nga QQ përfshijnë transfertat e pakushtëzuara të ministrisë së financave, transfertat e kushtëzuara për projekte të caktuara të ministrive të linjës dhe FZSHH si edhe transfertat të qeverisë qendrore për funksione të deleguara apo specifike.
- Programet buxhetore janë ato zëra të shpenzimeve të buxhetit të cilat financojnë funksionet ligjore të bashkisë të cilat janë funksione të veta ose funksione të deleguara nga qeveria qendrore.
- Treguesit kyc financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre

- **Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave** = Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave, me pak ndryshime – raporti tregon sesa shpenzon njësia për të ofruar një Lek shërbime publike
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave** = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitive për njësinë pasi tregon se njësia nuk mbështetet në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- **Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave** = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitive për njësinë pasi tregon se njësia nuk mbështetet në burime të jashtme (si transfertat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- **Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave** = tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta.
- **Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre** = Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përheshme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave
- **Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore
- **Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve** = Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- **Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave** = huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një raport / normë e ulët tregon se bashkia është e aftë ta paguajë borxhin (principal + interesin) sipas afatit të caktuar, një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do ti duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin
- **Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave** = Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- **Norma e shpenzimeve për politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve** = Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.



Përmirësim



E njëjta situatë



Përkeqësim

NI Nuk ka informacion

INFORMACION MBI SHPENZIMET

Realizim i shpenzimeve korrente

Shpenzimet korrente, përfshirë edhe shpenzime për paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve të bashkisë janë realizuar në vlerën 2,265,624 mijë lekë. Shpenzimet korrente kanë zënë 78% të shpenzimeve totale buxhetore dhe krahasuar me vitin 2018 pesha e shpenzimeve korrente në buxhet është rritur në masën 0.6%. Realizimi i shpenzimeve të personelit krahasuar me planin e vitit 2019 është në masën 84.9%. Shpenzimet korrente janë përqëndruar kryesisht në programet Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi, Menaxhimi i mbetjeve.

Realizim i shpenzimeve kapitale

Shpenzimet kapitale në vitin 2019 kanë qenë në vlerën 639,961 mijë lekë, ose sa 22% e shpenzimeve totale të bashkisë. Projektet kryesore të investimeve janë përqëndruar në Rrjetin rrugor rural ku investimet kanë zënë rreth 54% të buxhetit të alokuar në këtë program, menaxhimin e transportit rrugor, ndriçimin e rrugëve, planifikimi menaxhimi dhe administrimi etj.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet buxhetore sipas programe buxhetore të përdorura nga bashkia.


Fakt 2017	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2017
Fakt 2018	Buxheti i shpenzuar nga bashkia për secilin program buxhetor në vitin 2018
Plan 2019	Buxheti i planifikuar nga bashkia për secilin program buxhetor në buxhetin e vitit 2019
2019 vs 2018	Ndryshimi i buxhetit të shpenzuar nga bashkia në vitin 2019 kundrejt atij të shpenzuar në vitin 2018 në përqindje
Fakt 2019 vs Plan 2019	Përqindja faktike e realizimit të buxhetit kundrejt planit të vitit 2019

SHPENZIMET BUXHETORE

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	974,652	989,919	941,004	909,518	-8.1%	96.7%
Rrjeti rrugor rural	187,199	203,788	686,138	508,845	149.7%	74.2%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	258,521	265,560	382,170	270,265	1.8%	70.7%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	218,755	232,721	314,449	266,135	14.4%	84.6%
Menaxhimi i mbetjeve	132,574	190,374	208,445	190,656	0.1%	91.5%
Sport dhe argëtim	94,863	122,500	171,243	141,994	15.9%	82.9%
Ndriçim rrugësh	81,754	99,553	106,464	102,904	3.4%	96.7%
Shërbime publike vendore	59,446	75,098	143,693	93,290	24.2%	64.9%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	71,078	75,262	109,078	77,998	3.6%	71.5%
Arsimi profesional	25,351	34,831	80,283	62,263	78.8%	77.6%
Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile	44,287	47,680	73,095	49,985	4.8%	68.4%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	86,408	100,590	89,535	48,033	-52.2%	53.6%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	65,913	59,216	83,160	46,172	-22.0%	55.5%
Furnizimi me ujë	189	0	102,504	41,408		40.4%
Gjendja civile	31,183	18,102	22,599	20,206	11.6%	89.4%
Shërbimet e Policisë Vendore	13,788	15,975	27,864	16,324	2.2%	58.6%
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	7,911	7,262	22,738	15,640	115.4%	68.8%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,168	11,342	28,603	13,270	17.0%	46.4%
Transporti publik	12,293	9,549	18,459	10,658	11.6%	57.7%
Strehimi social	0	7,933	23,867	7,752	-2.3%	32.5%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	2,333	8,544	9,794	5,528	-35.3%	56.4%
Zhvillimi i turizmit	3,865	5,042	8,107	3,563	-29.3%	43.9%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	1,100	580	2,424	1,656	185.5%	68.3%
Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	0	11,571	2,708	1,037	-91.0%	38.3%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	18,064	17,094	1,639	485	-97.2%	29.6%

Sigurimi shoqëror	0	0	0	0		
Fondi rezervë + kontigjenca	0	0	685	0		0.0%
Programet e mbrojtjes së mjedisit	0	0	0	0		
Ndërgjegjësimi mjedisor	0	0	0	0		
Planifikimi Urban Vendor	0	0	15,495	0		0.0%
Shërbimet e kujdesit parësor	0	0	1,500	0		0.0%
TOTALI	2,402,695	2,610,086	3,677,744	2,905,585	11.3%	79.0%

ILUSTRIM PËR SHPENZIMET



FAKT 2019
vs
FAKT 2018



11.3%

FAKT 2019
vs
PLAN2019




-21.0%

BURIMET E FINANCIMIT

BURIMET						
1'000 LEK	FAKT 2017	FAKT 2018	PLAN 2019	FAKT 2019	2019 vs 2018	FAKT 2019 vs PLAN 2019
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	624,684	745,034	692,010	682,069	-8.5%	98.6%
Të ardhura nga taksat lokale	278,096	280,071	313,463	268,810	-4.0%	85.8%
Të ardhura nga taksat e ndara	57,207	81,214	74,560	94,614	16.5%	126.9%
Të ardhura nga tarifa vendore	241,838	305,624	287,428	287,610	-5.9%	100.1%
Të ardhurat e tjera	47,543	78,125	16,559	31,035	-60.3%	187.4%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	1,946,673	1,928,213	1,941,887	1,941,887	0.7%	100.0%
Transferta e pakushtëzuar	555,124	606,231	630,668	630,668	4.0%	100.0%
Transferta e kushtëzuar	1,077,963	970,505	954,908	356,311	-63.3%	37.3%
Trasferta specifike	313,586	351,477	356,311	954,908	171.7%	268.0%
HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0
Huamarrja afatshkurtë	0	0	0	0	0	0
Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	489,707	342,615	1,036,250	1,036,250	202.5%	100.0%
Trashëgimi pa destinacion	489,707	310,751	368,675	368,675	18.6%	100.0%
Trashëgimi me destinacion	0	31,864	667,575	667,575	1995.1%	100.0%
TOTAL BURIME FINANCIARE	3,061,064	3,015,862	3,670,147	3,660,206	21.4%	99.7%
Jashtë thesarit			7,596	7,596		100.0%
TOTAL BURIME FINANCIARE	3,061,064	3,015,862	3,677,743	3,667,802	21.6%	99.7%

BURIMET E FINANCIMIT NË VITIN 2019

ANALIZA E TE ARDHURAVE




- TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
- TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
- HUAMARRJA
- TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR

Gjatë vitit 2019 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka. Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.


Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbeshtetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj.

TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA




- Të ardhura nga taksat lokale
- Të ardhura nga taksat e ndara
- Të ardhura nga tarifa vendore
- Të ardhurat e tjera

TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR




- Transferta e pakushtëzuar
- Transferta e kushtëzuar
- Trasferta specifike

TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



- Trashëgimi pa destinacion
- Trashëgimi me destinacion



NDRYSHIMI KUNDREJT VITIT PARARDHËS

↓ **-8.5%** BURIMET E VETA TË FINANCIMIT

↑ **0.7%** TË ARDHURA NGA BUXHETI QËNDROR

↑ **202.5%** TRASHËGIMIA E VITIT TË SHKUAR

= TË ARDHURAT NGA HUAMARRJA

**PESHA E SHPENZIMEVE BUXHETORE SIPAS PROGRAMEVE NË RAPORT
ME TOTALIN E SHPENZIMEVE**

PROGRAMET NË RAPORT			
Programe	Raporti kundrejt total 2017	Raporti kundrejt total 2018	Raporti kundrejt total 2019
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	40.6%	37.9%	31.3%
Rrjeti rrugor rural	7.8%	7.8%	17.5%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	10.8%	10.2%	9.3%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	9.1%	8.9%	9.2%
Menaxhimi i mbetjeve	5.5%	7.3%	6.6%
Sport dhe argëtim	3.9%	4.7%	4.9%
Ndriçim rrugësh	3.4%	3.8%	3.5%
Shërbime publike vendore	2.5%	2.9%	3.2%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	3%	2.9%	2.7%
Arsimi profesional	1.1%	1.3%	2.1%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	1.8%	1.8%	1.7%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	3.6%	3.9%	1.7%
Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	2.7%	2.3%	1.6%
Furnizimi me ujë	0%	0%	1.4%
Gjendja civile	1.3%	0.7%	0.7%
Shërbimet e Policisë Vendore	0.6%	0.6%	0.6%
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	0.3%	0.3%	0.5%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0.5%	0.4%	0.5%
Transporti publik	0.5%	0.4%	0.4%
Strehimi social	0%	0.3%	0.3%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	0.1%	0.3%	0.2%
Zhvillimi i turizmit	0.2%	0.2%	0.1%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	0%	0%	0.1%

Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	0%	0.4%	0%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	0.8%	0.7%	0%
Sigurimi shoqëror	0%	0%	0%
Fondi rezervë + kontigjenca	0%	0%	0%
Programet e mbrojtjes së mjedisit	0%	0%	0%
Ndërgjegjësimi mjedisor	0%	0%	0%
Planifikimi Urban Vendor	0%	0%	0%
Shërbimet e kujdesit parësor	0%	0%	0%

PROGRAMET NË FOKUS TË BASHKISË

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
31.3%



Rrjeti rrugor rural
17.5%




Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
9.3%



Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
9.2%



SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK



	2017	2018	2019
■ Shpenzime Korente	2,092,535	2,261,546	2,265,624
■ Shpenzime Kapitale	310,160	348,540	639,962
Total Shpenzime	2,402,695	2,610,086	2,905,585

TRENDI I INVESTIMEVE

RRITJE E INVESTIMEVE GJATË
VITIT 2019



RRITJE E INVESTIMEVE
NË VITIN
2018 KUNDREJT 2017



PROGRAMET MË TË MBËSHTETURA ME INVESTIME



Rrjeti rrugor rural
72.7 %



Sport dhe argëtim
4.6 %



Ndriçim rrugësh
3.7 %




Planifikimi Menaxhimi
dhe Administrimi
3 %

PROJEKTET KRYESORE TË INVESTIMEVE TË REALIZUARA NGA BASHKIA

Projekti	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projekti	Buxheti — Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	% e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019)	Komente
Rikonstruksion Rrugë Velipojë Plazh	57,822	2019	2019	80,759	57,822	57,431	99%	Likuiduar pjesërisht
Rikonstruksion rruga "Lugoçesme"	44,437	2018	2019	44,421	44,437	44,421	100%	Përfunduar
Rikualifikim Urban blloqebanimit "Qemal Dracini" (tek Sahati)	23,042	2018	2019	23,033	23,042	23,023	100%	Përfunduar
Rikonstruksion i rruges Rragam - Sheldi Loti 1 Loti 2	25,347	2018	2019	31,939	25,347	19,031	75%	Përfunduar
Rikonstruksion rruga "Vllaznimit"	21,115	2018	2019	18,860	21,115	17,462	83%	Përfunduar
Rikonstruksion Rrugë Gjergj Jakin Berdica e Siperme, rrugë Palokajve Berdica e Madhe	18,815	2018	2019	16,947	18,815	16,940	90%	Përfunduar
Rikonstruksion Rrugë Udhakryq	15,437	2019	2019	25,288	15,437	15,355	99%	Likuiduar pjesërisht
Projekti "Jeto me Sportin" Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat Oso Kuka, B. Shkoder, Ana e Malit, Oblike dhe "At Gjoni Kama" Gur i Zi (FZHR)	17,941	2018	2019	17,941	14,712	14,712	100%	Përfunduar
Kanali ujitës KU-21	14,510	2019	2019	14,067	14,510	14,067	97%	Përfunduar
Rikonstruksion rrugë Oblike Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Cunit-Kryqezim Lagjja Garuc)	14,762	2018	2019	24,131	14,762	13,075	89%	Përfunduar
Rikonstruksion i rruges së Shirqit	13,066	2018	2019	13,057	13,066	13,057	100%	Përfunduar
Rikonstruksion I rrjetit kryesor të ujësjellesit dhe ndërtimi I rrjetit të brendshëm	61,304	2018	2020		61,304	12,208	20%	Në proces

teujesjellesit ne fshatrat,Kullaj,Guci,Stoj I ri, Shtoj Ivjeter,Vinoteka dhe Fshat I Ri(Pularia),Hot I Ri ,Grud e Re								
Ndertim fusha sportive	12,075	2018	2019	12,031	12,075	12,004	99%	Përfunduar
Rikonstruksion I bllokut tepallateve "Xhabije" M991380-FZHR	46,520	2016	2018	46,520	11,897	11,897	100%	Përfunduar
Rikonstruksion i rruges seMalesoreve te Mullirit	16,241	2018	2019	10,555	16,241	10,555	65%	Përfunduar
Projektim Ndertim trotuaridhe Sistemim kanali Gomsiqe	10,452	2018	2019	10,427	10,452	10,452	100%	Përfunduar
Rikonstruksion rruga"Ludertune"	10,092	2018	2019	10,077	10,092	10,077	100%	Përfunduar
Sistemim asfaltim i rrugesOblike-Lagje e re	12,221	2018	2019		12,221	10,071	82%	Përfunduar
Projekte per permiresimin ekushteve te banimit perkomunitete te pafavorizuara	15,221	2018	2019	15,221	7,289	7,287	100%	Përfunduar
Rini e fuqizuar , e Ardhme e Qendrueshme-PoteArdhmes(IADSA)	49,349	2016	2018	49,349	1,001	1,001	100%	Përfunduar

PESHA E INVESTIMEVE SIPAS PROJEKTEVE NE VITIN 2019




TREGUESIT FINANCIAR


TREGUESIT

SITUATA FINANCIARE


Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave




Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave




Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve




Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale




Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve



Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave



Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve



Bashkia ka financuar 30 programe buxhetore përkatëse të ndara në 9 funksione të saj ligjore:

Shërbimet e Përgjithshme Publike

01170-Gjendja civile

01110-Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Rendi dhe Siguria Publike

03140-Shërbimet e Policisë Vendore

03280-Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Çeshtjet Ekonomike

04160-Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

04130-Mbështetje për zhvillimin ekonomik

04260-Administrimi i pyjeve dhe kullotave

04240-Menaxhimi i infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit

04220-Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve

04570-Transporti publik

04520-Rrjeti rrugor rural

04760-Zhvillimi i turizmit

Mbrojtja Mjedisore

05100-Menaxhimi i mbetjeve

05200-Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve

05320-Programet e mbrojtjes së mjedisit

05630-Ndërgjegjësimi mjedisor

Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit

06140-Planifikimi Urban Vendor

06260-Shërbime publike vendore

06330-Furnizimi me ujë

06440-Ndriçim rrugësh

Shëndetësia

07220-Shërbimet e kujdesit parësor

Argëtimi, Kultura dhe Feja

08130-Sport dhe argëtim

08220-Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Arsimi

09120-Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

09240-Arsimi profesional

09230-Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Mbrojtja Sociale

10140-Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

10220-Sigurimi shoqëror

10430-Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

10661-Strehimi social

01 Shërbimet e Përgjithshme Publike

Programet buxhetore:



01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi



01170 Gjendja civile

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi



Ky program zë 9.3% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj., shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore apo shërbime që lidhen me prodhimin dhe përhapjen e informacionit publik.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet qeverisje vendore e përgjegjshme dhe administrata e saj transparente. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje, Krijimi i një institucioni eficient të dixhitalizuar, Rritja e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit nga administrata e bashkisë

01110-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	230,220	250,857	352,744	251,093	0.1%	71.2%
Kapitale	28,301	14,703	29,426	19,172	30.4%	65.2%
Total	258,521	265,560	382,170	270,265	1.8%	70.7%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Numri i moduleve elektronike në shërbim të qytetarëve	8	8	8	100.0%
Punonjës të bashkisë në total	271	271	271	100.0%
Numri i organeve të zgjedhura vendore (këshilli i bashkisë dhe kryepletë) të mbështetura	132	135	135	100.0%
Numri i personave të pritur gjatë pritjeve të organizuara të përfaqësive të institucioneve vendase dhe të huaja	250	816	950	116.4%
Pajisje informatike të mirëmbajtura	5	8	22	275.0%
Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (tik) të reja të blera në vit	35	22	16	72.7%
Numri i aplikimeve për regjistrimin e pronave në pronësi të bashkisë	37	80	80	100.0%
Numri i ditëve të trajnimit në vit			228	
Numri i personave të trajnuar	77	137	89	65%
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	16	16	8	50%
Numri total i punonjësve të bashkisë	1049	1053	1053	100%


QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisje vendore e përgjegjëse dhe administrata e saj transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e mbështetjes për organet e zgjedhura vendore (Numri i organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepleqtë) të mbështetura, ndryshimi në numër në vit)		3	3		100%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Krijimi i një institucioni eficient të dixhitalizuar


TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Përmirësimi i infrastrukturës teknike (Pajisje informatike të mirëmbajtura, ndryshimi vjetor në %)		60%	340%		567%
Përmirësimi i shërbimit TIK (Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të reja të blera në vit)	35	22	16		73%
Rritja e aplikimeve për regjistrimin e pronave (Numri i aplikimeve për regjistrimin e pronave në pronësi të bashkisë Shkodër, ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		116%	116%		100%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional


TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm institucional(Numri i personave të pritur gjatë pritjeve të organizuara të përfaqësive të institucioneve vendase dhe të huaja, ndryshimi vjetor në %)		226.4%	280%		124%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë(Raporti mesatar i ditëve të trajnimit ndaj personave të trajnuar (ditë trajnimi/person))			2.6		
Rritja e qëndrueshmërisë së administrates civile(Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në % i qëndrueshmërisë))	98%	98%	99%		101%

Gjendja civile



Ky program zë 0.7% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia alokon fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore

PËRSHKRIM REALIZIMI

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet sigurimi i hedhjes, ruajtjes dhe ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në r.sh.. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për gjendjen civile.

01170-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	31,183	18,102	22,599	20,206	11.6%	89.4%
Kapitale	0	0	0	0	0%	0%
Total	31,183	18,102	22,599	20,206	11.6%	89.4%

03 Rendi dhe Siguria Publike



Programet buxhetore:



03140 Shërbimet e Policisë Vendore



03280 Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile

Shërbimet e Policisë Vendore



Ky program zë 0.6% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore të nevojshme për sigurimin e mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ekzekutimin dhe zbatimin e akteve të tjera të nxjera nga Kryetar i Njësisë dhe vendimet e Këshillit të Njësisë.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet përmirësimi i sigurisë së komunitetit. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Rritja e shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për sigurinë në komunitet.

03140-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	13,788	15,975	19,201	16,324	2.2%	85.0%
Kapitale	0	0	8,663	0	0%	0%
Total	13,788	15,975	27,864	16,324	2.2%	58.6%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Numri total i punonjësve të policisë bashkiake	24	24	22	91.7%
Kamera të vendosura në pika strategjike të qytetit	0	41	41	100.0%
Numri i uniformave për punonjësit e policisë bashkiake	24	24	24	100.0%



QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Përmirësimi i sigurisë së komunitetit

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e sigurisë së qytetit (Numri i kamerave të vendosura në pika strategjike të qytetit)	0	41	41		100%
Policë bashkiakë të pajisur me uniforma (Numri i policëve bashkiak kundrejt numrit të uniformave (uniforma/policë))	1	1	1.1		110%

Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile



Ky program zë 1.7% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzime buxhetore për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimin në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

PËRSHKRIM REALIZIMI

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, përbytyjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Ofrimi i ndihmës për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile.

03280-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	44,287	42,016	62,759	48,291	14.9%	76.9%
Kapitale	0	5,664	10,336	1,694	-70.1%	16.4%
Total	44,287	47,680	73,095	49,985	4.8%	68.4%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Familje të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të shpërblyera	59	40	19	47.5%
Shpenzime për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore etj	1,520	3,000	1,540	51.3%
Koha e daljes nga stacioni në sekonda (pas marrjes së njoftimit)	1	1	1	100%
Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit	275	650	504	78%



QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit, permbytjeve dhe fatkeqësive natyrore dhe ndërhyrjeve për shpëtim


OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Ofrimi i ndihmës për familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet (Numri i familjeve të shpërblyera, ndryshimi vjetor në %)		-32%	-68%		213%
Rritja e masës së shpërblimit (Shpenzime për shpërblime kundrejt numrit të familjeve të shpërblyera (mijë lekë/familje))	25.8	75	81.1		108%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT**Përmirësimi i shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit****TREGUESIT E PERFORMANCËS**

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Koha e daljes nga stacioni(Koha e daljes nga stacioni, ndryshimi në sekonda kundrejt vitit të kaluar)		0	0	=	
Përmirësimi i shërbimit ndaj komunitetit (Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në %))		136%	83%		61%

04 Çeshtjet Ekonomike



Programet buxhetore:



04130 Mbështetje për zhvillimin ekonomik



04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve



04240 Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit



04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave



04520 Rrjeti rrugor rural



04570 Transporti publik



04760 Zhvillimi i turizmit



04160 Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Mbështetje për zhvillimin ekonomik



Ky program zë 0.2% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; Funksionimi ose mbështetja me politika v endore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ; Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj. Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj. Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin

PËRSHKRIM REALIZIMI

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2019 ne programin ka qellim te programit te saj këto funksione zhvillimi: Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

04130-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	2,333	8,544	9,794	5,528	-35.3%	56.4%
Kapitale	0	0	0	0	0%	0%
Total	2,333	8,544	9,794	5,528	-35.3%	56.4%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Numri i botimeve	2	1	0	0.0%
Numri i panairove për promovim biznesi	12	10	8	80.0%
Numri i projekteve të aplikuara për financim nga be	3	3	3	100.0%
Iniciativa biznesi të mbështetura	1	2	1	50.0%
Koha e pajisjes me dokumentacion pranë qkb	1	1	1	100.0%
Shpenzime për mbështetjen e iniciativave të biznesit	1,600	2,600	1,600	61.5%

QELIMI I PROGRAMIT BUXHETOR



Lehtësimi i biznesit

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik vendor, strategjive dhe planeve zhvillimore lokale

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Ulja e kohës së pajisjes me dokumenta nga QKB(Ndryshimi në ditë i pajisjes me dokumenta krahasuar me vitin e kaluar)		0	0	=	
Rritja e numrit të aplikimeve për projekte (Numri i projekteve të aplikuara, ndryshimi vjetor në %)		0%	0%	=	

Rritja e mbështetjes për biznesin(Panaire të organizuara nga bashkia, ndryshimi në përqindje kundrejt vitit të kaluar)		-17%	-33%		194%
Rritja e mbështetjes së iniciativave të biznesit(Shpenzime të bashkisë për mbështetjen e iniciativave kundrejt numrit të iniciativave të mbështetura (lekë/iniciativë))	1,600	1,300	1,600	=	123%
Materiale informuese për zhvillim(Numri i materialeve informuese të botuara për zhvillim)	2	1	0		0%

Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve



Ky program zë 0.1% të shpenzimeve totale të bashkisë

PËRSHKRIM PROGRAMI

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave; Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore; Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve; Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë; Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë; Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural; Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës

PËRSHKRIM REALIZIMI

Faktoret që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara. 1. Për krijimin e kadastrës bujqësore dhe arshivës ka qënë e nevojshme paisja /terheqja e dokumentacioneve nga Z.V.R.P.P. Shkodër, kundrejt pagesës, por nuk është arritur të finalizohet për arsye të mungesës së kapaciteteve në burime njerezore nga ky institucion. Jemi në pritje të përmbushjes së këtij objekti.

04220-SHPENZIMET E PROGRAMIT

2019	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	2019 vs 2018	Fakt 2019 vs Plan 2019
Korrente	1,100	580	2,424	1,656	185.5%	68.3%
Kapitale	0	0	0	0	0%	0%
Total	1,100	580	2,424	1,656	185.5%	68.3%

PRODUKTET E PROGRAMIT

	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Realizimi Faktik
Numri i qenve të trajtuar	170	225	225	100.0%
Shpenzime për trajtimin e qenve	700	1,000	972	97.2%
Numri i përfituesve (numri i përfituesve individual, numri i sh.b.b, numri i agropërpunesve) në programet e mbështetjes nga donatorët	65	150	95	63.3%


QELLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqesore si dhe të kategorive të resurseve të tjera

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përthithja e granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural


TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
Rritja e përfituesve nga grantet (Numri i përfituesve, ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)		131%	46%		35%

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Qenj që përfitojnë shërbime dhe trajtohen.
Ekzistenca dhe funksionimi i një strehëze për
qent e rrugës

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Matja e Treguesve të Performancës	Fakt 2018	Plan 2019	Fakt 2019	Trendi 2019 vs 2018	Realizimi Faktik
